



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr.110-455, të dt. 31. 3.02008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2008, merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE RREGULLUESE “QENDRA 1” NË PRISHTINË
01nr. 35-588, dt. 27.12.2006

Neni 1

Neni 2, par. 2 i Vendimit 01 nr. 35-588, të dt. 27.12.2006, ndryshohet dhe thuhet:

“Kriteret urbane të përmbajtjeve, nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat përfshijnë hapësirën prej 4.450 m² e përfshirë në pjesën e ngastrave kadastrorë 4874/7, në sipërfaqe prej 00.11,44 ha, fleta poseduese nr. 4137, Zona kadastrorë Prishtinë, pasuri shoqërore-shfrytëzues Kuvendi i Komunës, ngastra nr. 7735/2 në sipërfaqe prej 00.12,46 ha, fleta poseduese 10395, Zona kadastrorë Prishtinë, pasuri shoqërore – shfrytëzues Drejtoria e Rrugëve të Kosovës dhe ngastra nr. 5619/2 me sipërfaqe prej 00.20,60 ha, fleta poseduese 2454, Zona kadastrorë Prishtinë, pasuri shoqërore - shfrytëzues Kuvendi i Kosovës, të cilat janë të përcaktuara në kuadër të Planit rregullues “Qendra 1”, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-181096, të dt. 3.8.2005.”

Neni 2

Neni 5 i Vendimit ndryshohet dhe thuhet:

“Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit”.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. NR. 35-1774, më 26.11.2008

KRYETAR I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa

A r s y e t i m

Drejtoria e Planifikimit Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, me rastin e hartimit të Propozimvendimit për realizimin e përmbajtjeve të Planit rregullues të lagjes “Qendra 1” në Prishtinë, në bazë të kontratës për koncesion, në nenin 2, paragrafi 2 është bërë një lëshim i natyrës teknike gjatë përshkrimit të sipërfaqes që përfshinë një hapësirë prej 1530 m² dhe do të duhej të ishte: “sipërfaqja 4.450m² e përfshirë në pjesët e ng. kadastrore nr. 4874/7, në sipërfaqe prej 00.11.44 ha, fleta poseduese nr. 4137, Z. kadastrore Prishtinë, pasuri shoqërore - shfrytëzues Kuvendi i Komunës; ngastra kadastrore nr. 7735/2 në sipërfaqe prej 00.12.46 ha, fleta poseduese nr. 10395, Zona kadastrore Prishtinë, pasuri shoqërore - shfrytëzues Drejtoria e Rrugëve të Kosovës, dhe ngastra kadastrore nr. 5619 /2, në sipërfaqe prej 00.20,60 ha, fleta poseduese 2454 , Zona kadastrore Prishtinë, pasuri shoqërore, shfrytëzues Kuvendi i Kosovës.